



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
NJESIA E PROKURIMEVE

Nr. 19/52 Prot

Shkodër, më 28.12.2022

KONTRATË SIPERMARRJE SHËRBIMI NR.3  
REF-00640-07-09-2021

“OFRIMI I SHËRBIMIT TË GJELBRIMIT NË BASHKINË E SHKODRËS”

BASHKIA SHKODËR  
DHJETOR 2022



IMPEX  
SHKODËR ALBANIA

## KONTRATË SIPERMARRJE SHËRBIMI NR.3

REF-00640-07-09-2021

### “OFRIMI I SHËRBIMIT TË GJELBRIMIT NË BASHKINË E SHKODRËS”

E lidhur sot me datë \_\_\_\_\_, midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkoder, e përfaqësuar nga **Z.Bardh Spahia** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Shkoder që në vijim do të quhet **Autoriteti Kontraktor**.

**Dhe** Operatorit ekonomik ” **Malvin**”sh.p.k. regjistruar ne regjistrin fillestar me nr. CN-041387-09-07 dhe licence te shoqerise kodi III.7.A nr.LN-2268-10-2016/2 date 14.11.2016 me vlefshmeri te licences pa afat leshuar nga Ministria e e Financave dhe Ekonomise me seli te shoqerise: Rruga Jorgji Karamitri-Shkoder me **NUIS J 76403034 Q.** e perfaqesuar nga Perfaqesuesi Ligjor i shoqerise **Z.Skënder Halilaj** me zotësi të plotë juridike e për të vepruar dhe kompetencë të plotë për të përfaqësuar shoqërinë në të gjitha marrdhëniet që burojnë prej kësaj kontrate me autoritetin Kontraktor, Bashkia Shkoder për realizimin e objektit të kontratës. Në vijim do të quhet”**Kontraktuesi**”.

#### Neni 1

##### Baza ligjore

- Kodi Civil ligji nr.7850, dt. 29.07.1994, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 162, dt. 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 52 të ligjit.
- VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 59, nenit 60, pika 1/a) e nenit 64, nenit 65 të kreu VI.
- Ligji nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar.
- Udhëzimit nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- Marreveshjes kuader nr.11392/8 prot date 08.11.2021

#### Neni 2

##### Objekti i kontratës

- 2.1. Objekt i kësaj kontrate është ofrimi i shërbimit të gjelbrimit në Bashkinë e Shkodrës në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të dhëna në dokumentat e tenderit dhe që **Kontraktuesi – “Malvin” sh.p.k.** pranon t’i realizojë sipas ofertës së ofruar dhe pranuar si fituese në procedurën e prokurimit.

#### Neni 3

##### Vlefte e kontratës

- 3.1. Kontraktuesi merr përsipër të kryejë të gjitha shërbimet tek Autoriteti Kontraktor sipas objektit të lartpërmendur në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të dhëna në dokumentat e tenderit, kundrejt një vlere prej **34,218,988** (Tridhjetë e katërmilion e dyqind e tetëmbëdhjetemije e nentëqind e tetëdhjetë e tete) lekë pa tvsh dhe **41,062,786** (Dyzet e njëmilion e gjashtëdhjetë e dymije e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë).

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr 1, Shkodër, ëëb:ëëë [bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

**MALVIN SH.P.K.**  
**I MAMUK**  
**SHKODER - ALBANIA**

**BASHKIA SHKODER**  
**REJZ**

- 3.2. Financimi realizohet nga Buxheti i Bashkise Shkoder.
- 3.3. Çmimet e kontraktorit për shërbimet e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij. Bazuar në VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 12, pika 10 Autoriteti Kontraktor siguron kontraktuesin për rishikimin e vlerës, në përputhje me inflacionin e publikuar.

#### Neni 4

##### Afati i kontratës

- 4.1 Afati i realizimit të shërbimit do të jete nga data **01.01.2023** deri me **31.12.2023**.

#### Neni 5

##### Gjuha e kontratës

- 5.1 Gjuha e kontratës është gjuha shqipe.

#### Neni 6

##### Qëllimi

- 6.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruarra me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 6.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 6.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 6.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 6.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### Neni 7

##### Përkufizime

##### 7.1 Kontrata

- "Kontrata" do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me LPP.

- "Dokumentet e Kontratës" do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.
- "Çmimi i Kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet Furnizuesit siç specifikohet në kontratë.
- "Përfundimi" do të thotë përmbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitet, nga Furnizuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.
- "Ndërprerje e Kontratës" do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktimeve në Nenin 23.
- "Specifikime teknike" do të thotë karakteristikat e Shërbimeve objekt kontrate dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.
- "Termet e Referencës" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.
- "Listat" do të thotë dokumenti (et) me titull Listat të plotësuar nga Furnizuesi dhe të dorëzuara me ofertën, siç janë të përfshira në Kontratë . Dokumente të tilla mund të përfshijnë Listat e Çmimeve të dhëna, Listat e tarifave dhe / ose çmimeve.
- "Ofertë" do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Furnizuesi ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.
- "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## 7.2 Palët e Kontratës

- "Palë" do të thotë nënshkruesit e kontratës, në cilësinë e Blerësit dhe Furnizuesit sipas kontekstit.
- "Blerës" do të thotë Autoriteti Kontraktor përfituesi i Shërbimeve objekt kontrate.
- "Nënkontraktor" do të thotë çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për kryerjen e një pjese të Shërbimeve.

## 7.3 Llogaritja e afateve

- "Ditë" do të thotë një ditë kalendarike.

## 7.4 Shërbimet


- "Shërbime" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Furnizuesi sipas Kontratës.

## 7.5 Përkufizime të tjera

- "Adresa e Blerësit" është adresa e specifikuar në KVK.
- "Forca Madhore" është përcaktuar në Nenin 20 "Forca Madhore".
- "Sigurimi i Kontratës" është sipas përcaktimeve të Nenit 11 "Sigurimi i Kontratës".

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr 1, Shkodër, eeb eeb bashkiashkoder.gov.al | e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

MALVIN SHK  
I M P E M  
SHKODER-ALBANIA



- "Vendi i kryerjes së Shërbimeve", do të thotë vendi i përcaktuar në KVK.
- "E paparashikueshme" ose "E paparashikuar" do të thotë një ngjarje objektive isht e pamundur të parashikohet në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE.
- Modifikimi i kontratës" është sipas përcaktimeve në Nenin 21.
- "Legjislacioni në fushën e prokurimit" do të thotë LPP-ja, Rregullat e Prokurimit Publik dhe akte të tjera nënligjore në bazë dhe për zbatim të LPP –së siç specifi kohet në KVK.
- "Praktikat e Ndaluar" kanë kuptimin e përcaktuar në LPP.
- "**Situacioni**" quhet dokumenti i evidentimit faktik të situatës së punës së kryer në përputhje me zërat e punimeve të përcaktuara në kontratë (volumet).
- "**Supervizori**" quhet personi kompetent i emëruar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër i cili është përgjegjës për mbikqyrjen e realizimit të shërbimit të gjelberimit dhe administrimit të kontratës.
- "**Drejtori Teknik** i Shërbimit të Mirembajtjes së Siperfaqeve të Gjelberta është personi i aprovuar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia e Shkodrës, përfaqësues i Kontraktuesit, përgjegjës për kryerjen e shërbimeve të Mirembajtjes së Siperfaqeve të Gjelberta.
- 

## 7.6 Interpretimi

Interpretimi i Kontratës, përveç kur konteksti kërkon ndryshe:

- fjalët që tregojnë një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë;
- fjalët që tregojnë njëjës përfshijnë edhe shumësin dhe fjalët që tregojnë shumësin përfshijnë edhe njëjës;
- dispozitat që përfshijnë fjalën "bë dakord", "rënë dakord" ose "marrëveshje" kërkojnë që marrëveshja të dokumentohet me shkrim;
- "i shkruar" ose "me shkrim" do të thotë i shkruar me dorë, i shkruar me makinë, printuar ose i bërë në mënyrë elektronike.

### 7.6.1 Modifikimi

Çdo modifikim i Kontratës i cili nuk kryhet me shkrim, dhe nuk përmban datën, apo nuk i referohet shprehimisht Kontratës dhe nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar rregullisht i secilës Palë është i pavlefshëm. Palët nuk mund të bëjnë modifikime të asnjë elementi të kontratës që do të sillnin ndryshime thelbësore në kushtet mbi bazën e të cilave është përzgjedhur Furnizuesi.

### 7.6.2 Heqja dorë

ALVIN SHPK  
IMPEX  
SHKODER - ALBANIA

Adresa: Rr 13 Dhjetori, Nr 1, Shkodër, eeb eëë [bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)



Çdo heqje dorë nga të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të një Pale sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Palës që bën këtë dorëheqje, dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën nga e cila po hiqet dorë.

### 7.6.3 Ndikimi i pavarur i dispozitave të kontratës

Nëse ndonjë dispozitë ose kusht i Kontratës është i ndaluar ose bëhet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, një ndalim, pavlefshmëri apo pazbatueshmëri e tillë nuk ndikon në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite dhe kushti tjetër të Kontratës.

### 7.7 Komunikimet

Kurdo këto Kushte parashikojnë dhënien ose lëshimin e miratimeve, certifikatave, pëlqimeve, përcaktimeve, njoftimeve, kërkesave dhe shlyerjeve këto komunikime do të jenë:

(a) me shkrim dhe të dorëzuara dorazi (kundrejt marrjes), dërguar me postë ose korrier, ose transmetuar duke përdorur ndonjë nga sistemet e rena dakord të transmetimit elektronik siç përshkruhet në KVK;

Dhe

(b) dorëzuar, dërguar ose transmetuar në adresën për komunikimet e marrësit siç përshkruhet në KVK. Sidoqoftë:

(i) nëse marrësi njofton një adresë tjetër, komunikimet do të dorëzohen në përputhje me rrethanat; dhe

(ii) nëse marrësi nuk ka deklaruar ndryshe kur kërkon një miratim ose pëlqim, mund të dërgohet në adresën nga e cila është lëshuar kërkesa.

Miratimet, pëlqimet dhe përcaktimet nuk do të mbahen ose vonohen pa arsye.

### 7.8 Ligji dhe gjuha

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Gjuha e Kontratës do të jetë ajo e deklaruar në KVK.

Gjuha për komunikime do të jetë ajo e deklaruar në KVK. Nëse aty nuk përcaktohet asnjë gjuhë, gjuha për komunikime do të jetë gjuha e përcaktuar e Kontratës.

Dokumentet mbështetëse dhe literatura e shtypur që janë pjesë e Kontratës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse dhe, për qëllime të interpretimit të Kontratës, ky përkthim do të mbizotërojë.

Furnizuesi do të përballojë të gjitha kostot e përkthimit dhe të gjitha risqet e saktësisë së një përkthimi të tillë, për dokumentet e siguruara nga Furnizuesi.

### 7.9 Prioriteti i Dokumenteve

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr 1. Shkodër, eeb ëëë bashkiashkoder.gov.al, e-mail info@bashkiashkoder.gov.al

MALVIN  
I M P E  
SHKODER - ALBANIA



Dokumentet që formojnë Kontratën duhet të konsiderohen reciprokisht shpjeguese të njëri-tjetrit. Nëse në dokumente gjendet një paqartësi ose mospërputhje, Blerësi lëshon çdo sqarim ose udhëzim të nevojshëm.

## 7.10 Hartimi i Kontratës

7.10.1 Njoftimi i ofertës fituese në përfundim të afateve të ankimit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.

7.10.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës.

## 7.11 E drejta e autorit

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, e drejta e autorit në të gjitha dokumentet dhe materialet e tjera që përmbajnë të dhëna dhe informacione të dhëna Blerësit nga Furnizuesi këtu do t'i mbeten Blerësit, edhe nëse ato i janë furnizuar Blerësit drejtpërdrejt ose përmes Furnizuesit nga ndonjë pale të tretë, përfshirë furnizuesit e materialeve.

## 7.12 Detaje Konfidenciale

Furnizuesi dhe personeli i Blerësit do të zbulojnë çdo informacion të tillë konfidencial dhe informacione të tjera që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme për të verifikuar pajtueshmërinë e Furnizuesit me Kontratën dhe për të lejuar zbatimin e duhur të saj.

Secili prej tyre do t'i trajtojë të dhënat e kontratës në mënyrë konfidenciale, deri në masën e nevojshme për të kryer detyrimet e tyre përkatëse sipas Kontratës ose për të qenë në përputhje me ligjet në fuqi. Asnjë prej tyre nuk do të publikojë ose zbulojë të dhëna të veçanta të Shërbimeve të përgatitura nga Pala tjetër pa marrëveshjen paraprake të Palës tjetër. Sidoqoftë, Furnizuesit lejohen të zbulojnë çdo informacion publikisht të disponueshëm, ose informacion që kërkohet për të provuar kualifikimet e tij për të konkurruar në procedura të tjera.

Pavarësisht nga sa më sipër, Furnizuesi mund t'i sigurojë Nënkontraktorit (eve) të tij dokumente, të dhëna dhe informacione të tjera që merr nga Blerësi në masën e kërkuar që Nënkontraktori (ët) të kryejë punën e tij sipas Kontratës. Në rast të tillë, Furnizuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me Nënkontraktorin/ët një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit sikurse parashikohet në adresë të Furnizuesit sipas këtij neni.

## 7.13 Pajtueshmëria me ligjet

Gjatë realizimit të Kontratës Furnizuesi respekton ligjet në fuqi.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në Kushtet e Veçanta:

(a) Blerësi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe ~~ose licencat nga të gjitha~~ autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që (i) autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Blerësit të sigurojë në emër të tij

dhe (ii) janë të domosdoshëm për ekzekutimin e Kontratës, përfshirë ato që kërkohen për përmbushjen e detyrimeve përkatëse si nga Furnizuesi ashtu dhe Blerësi sipas Kontratës;

(b) Furnizuesi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Furnizuesit të sigurojë në emër të tij dhe që janë të nevojshme për kryerjen e Kontratës, duke përfshirë, pa u kufizuar, vizat për personelin e Furnizuesit dhe Nënkontraktorit dhe lejet e hyrjes për të gjitha pajisjet e importuara të Furnizuesit. Furnizuesi siguron të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat e tjera që nuk janë përgjegjësi e Blerësit sipas pikës (a) të këtij neni këtu dhe që janë të nevojshme për ekzekutimin e Kontratës. Furnizuesi do të dëmshpërblejë dhe zhdëmtojë Blerësin nga dhe kundër çdo dhe të gjitha detyrimeve, dëmeve, pretendimeve, gjobave, penaliteteve dhe shpenzimeve të çfarëdo natyre që lindin ose rezultojnë nga shkelja e ligjeve të tilla nga Furnizuesi ose personeli i tij, duke përfshirë Nënkontraktorët dhe personelin e tyre, por pa cënuar Nenin 9.1.

#### **7.14 Përgjegjësia e përbashkët dhe solidare**

Nëse Furnizuesi është një bashkim i Operatorëve Ekonomikë, të gjithë këta Operatorë Ekonomikë do të jenë bashkërisht dhe solidarisht përgjegjës ndaj Blerësit për përmbushjen e dispozitave të Kontratës.

#### **7.15 Inspektimet dhe Auditimi nga Blerësi**

Furnizuesi i përgjigjet pyetjeve dhe i jep Blerësit çdo informacion ose dokument të nevojshëm për (i) hetimin e pretendimeve të Praktikave të Ndaluar, ose (ii) monitorimin dhe vlerësimin nga ana e Blerësit të Kontratës dhe për t'i dhënë mundësi Blerësit të shqyrtojë dhe adresojë çdo problematikë në lidhje me Kontratën.

Furnizuesi mban të gjithë dokumentacionin në lidhje me zbatimin e Kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Neni 8**

#### **Hartimi i Kontratës**

8.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.

8.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 9**

#### **Praktikat e Ndaluar**

MALVIN SHPK  
I MEX  
SHKODER, KV BANTA

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr 1, Shkodër, eeb.ëëë bashkiashkoder.gov.al, e mail: info@bashkiashkoder.gov.al





- 9.1 Furnizuesi nuk /do të autorizojë ose lejojë asnjë nga punonjësit ose përfaqësuesit e tij, të angazhohen në Praktika të Ndaluara në lidhje me prokurimin, dhënien ose ekzekutimin e Kontratës.
- 9.2 Nëse Blerësi konstaton se dhënia e kontratës është bërë në kushtet e konfliktit të interesit dhe ky fakt nuk ka qenë i mundur të identifikohet më parë, i kërkon Komisionit të Prokurimit Publik të deklarojë kontratën absolutisht të pavlefshme.
- 9.3 Nëse Blerësi gjatë zbatimit të kontratës ka informacion për veprime korruptive informon organet kompetente.

#### Neni 10

##### Njoftimet

- 10.1 Çdo njoftim i dhënë nga njëra Palë tek tjetra, në përputhje me Kontratën, do të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në KVK.
- 10.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

#### Neni 11

##### Objekti i Furnizimit

- 11.1 Mallrat dhe Shërbimet e Lidhura me to që do të furnizohen duhet të jenë sipas specifikimeve dhe kushteve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit. Kushtet e kontratës nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur Furnizuesi, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.
- 11.2

#### Neni 12

##### Dorëzimi

- 12.1 Dorëzimi i Mallrave dhe Përfundimi i Shërbimeve të Lidhura me to do të jetë në përputhje me kërkesat e specifikuar në Dokumentet e Tenderit.

#### Neni 13

##### Përgjegjësitë e Furnizuesit

- 13.1 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për furnizimin e të gjitha Mallrave dhe Shërbimeve të Lidhura me to të përfshira në Objektivin e Furnizimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.
- Kompania duhet të mbajnë të dhëna ditore në lidhje me elementet e grafikeve të proceseve të punës;
- ✓ Lista e punëtorëve dhe orët e punës cdo muaj;
  - ✓ Rakordimi i grafikeve mujore për proceset e punës shoqëruar me çmimet njëzore të proceseve;

- ✓ Komete/vërejtje për kërkesat e Bashkisë ose specialistit që monitoron shërbimin në lidhje me mungesën e cilësisë dhe sasisë.

**13.2** Kontraktuesi përgjigjet për punësimin dhe sigurimin e nëpunësve dhe punonjësve, sipas legjislacionit në fuqi. Kontraktuesi duhet të paraqesë një numër punonjësish jo më të vogël se numri i punonjësve të deklaruar në ofertën e tij. Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit kontraktor. çdo 6 (gjashtë) muaj, me datë 10 janar dhe 10 korrik, listën e të gjithë punonjësve të siguruar dhe të vërtetuar nga organi kompetent, si dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër në lidhje me punonjësit e Kontraktuesit.

**13.3** Kontraktuesi është i detyruar të caktojë Drejtorin teknik. Drejtori teknik është personi që Kontraktuesi ka përcaktuar në ofertën e tij. Drejtuesi Teknik i Punimeve të objektit është: Ing. Skender Halilaj.

Detyrat e Drejtorit Teknik të Punimeve janë si më poshtë:

- Zbatimin e shërbimit të mirembajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta.
  - Dokumentacionin teknik që është i detyrueshëm të mbahet;
  - Ecurinë e shërbimit të mirembajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta konform plan organizimit dhe grafikut të shërbimit;
- Në rast se ndryshohet Drejtori Teknik. Kontraktuesi duhet detyrimisht të lajmërojë me shkrim Autoritetin Kontraktor.
  - Drejtuesi teknik në këtë rast duhet të ketë të gjitha kualifikimet e kërkuara në dokumentat e tenderit për Drejtuesin teknik. Autoriteti Kontraktor mund të kundërshtojë emërimin e Drejtuesit Teknik nëse vlerëson se ai nuk përmbush kualifikimet e përcaktuara në Dokumentat e tenderit. Në këtë rast Kontraktuesi cakton një Drejtues teknik tjetër dhe detyrimisht lajmëron Autoritetin Kontraktor.

## Neni 14

### Çmimi i Kontratës

**14.1** Çmimi i kontratës do të jetë i pandryshueshëm përgjatë kohëzgjatjes së realizimit të Kontratës, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 21.

## Neni 15

### Kushtet e Pagesës

**15.1** Çmimi i Kontratës do të paguhet siç specifikohet në KVK.

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr 1, Shkodër. fëb eëë bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

MALVIN SAPK  
I M P E X  
SHKODER-ALBANIJA



Furnizuesi duhet të paguhet nga Blerësi për Mallrat e dorëzuara dhe Shërbimet e Lidhura me to të kryera, në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në Kontratë.

- 15.2** Pagesat do të kryhen menjëherë nga Blerësi, jo më vonë se periudha kohore e specifikuar në KVK pas dorëzimit të një fature ose kërkesë për pagesë nga Furnizuesi, dhe pasi Blerësi ta ketë pranuar atë.
- 15.3** Nëse nuk përcaktohet ndryshe në KVK, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë i fiksuar në ditën e dërgimit për publikim të njoftimit të kontratës.
- 15.4** Në rast të verifikimit të vonësave në kryerjen e pagesave nga ana e Blerësit, megjithëse Furnizuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

## Neni 16

### Sigurimi i Kontratës

- 16.1** Furnizuesi, brenda afatit të caktuar nga Blerësi në njoftimin e fituesit, paraqet Sigurimin e Kontratës në shumën e specifikuar në KVK.
- 16.2** Në përputhje me Nenin 10.1, Sigurimi i Kontratës do të shprehet në monedhën e Kontratës dhe do të jetë në formën e përcaktuar nga Blerësi në KVK.
- 16.3** Shuma nga Sigurimi i Kontratës do t'i paguhet Blerësit si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga mospërmbushja e detyrimeve sipas Kontratës nga ana e Furnizuesit.
- 16.4** Sigurimi i Kontratës do t'i kthehet Furnizuesit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së përmbushjes së detyrimeve së Furnizuesit sipas Kontratës, përfshirë çdo detyrim garancie, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në KVK.

## Neni 17

### Nënkontraktimi

- 17.1** Nënkontraktimi nuk duhet të bëhet pa aprovimin paraprak me shkrim të Blerësit dhe jo më shumë se 50% të vlerës së kontratës.
- 17.2** Blerësi lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për furnizimet që do të kryejë, me miratimin paraprak me shkrim të Furnizuesit
- 17.3** Parashikimet e Nenit 2 zbatohen edhe për nënkontraktimin.

## Neni 18

### Specifikime dhe Skicime

- 18.1** Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Furnizuesi duhet të përgatisë të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuar dhe të njohura në

përgjithësi të pranueshme për Blerësin dhe të marrë parasysh standartet më të fundit.

- 18.2** Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi. Furnizuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjënjese përse i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

## Neni 19

### Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

- 19.1** Furnizuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhdëmtuar Blerësin për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë. në kryerjen e Shërbimeve.
- 19.2** Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Furnizuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

## Neni 20

### Dëmet e likujduara

**20.1** Dëmet e likujduara për kryerjen e vonuar të shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

- Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së Kontratës.
- Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.
- Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

## Neni 21

### Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor

- 21.1** Furnizuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Blerësi përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në ofertën e Furnizuesit. Furnizuesi do të zëvendësojë çdo punonjës nëse Blerësi zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Blerësi është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.
- 21.2**

21.3 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Furnizuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.

21.4 Furnizuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkak i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Blerësit.

## Neni 22

### Zhdëmtimi i Patentës

22.1 Furnizuesi dëmshpërblen dhe zhdëmton Blerësin dhe zyrtarët e tij nga dhe kundër padive, veprimeve ose procedurave administrative, pretendimeve, kërkesave, humbjeve, dëmeve, kostove dhe shpenzime të çdo natyre, përfshirë tarifat e avokatit dhe shpenzimet, të cilat Blerësi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që përndryshe ekzistonte në datën e kontratës për shkak të:

(a) ofrimit të shërbimeve nga Furnizuesi ose përdorimit të shërbimeve në vendin e dorëzimit të Shërbimeve;

dhe

(b) shitjen në çdo vend të produkteve të prodhuara nga Shërbimet.

Një zhdëmtim i tillë nuk aplikohet nëse Shërbimet ose ndonjë pjesë e tyre përdoren përtej kushteve të kontratës ose përdorimi i tyre ose i një pjese të tyre bëhet në kombinim me ndonjë pajisje, impiant ose material tjetër që nuk është furnizuar nga Furnizuesi, në përputhje me Kontratën.

22.2 Nëse është nisur ndonjë procedurë apo ngritur ndonjë kërkesë kundër Blerësit që del nga çështjet e përmendura në Nenin 15.1, Blerësi do të njoftojë menjëherë Furnizuesin, dhe Furnizuesi mundet me shpenzimet e tij dhe në emër të Blerësit të ndërmarrë të gjitha veprimet për zgjidhjen e ndonjë procedure apo pretendimi të tillë.

22.3 Nëse Furnizuesi nuk e njofton Blerësin brenda tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së një njoftimi të tillë, atëherë Blerësi do të jetë i lirë të kryejë të njëjtën gjë në emër dhe për llogari të tij.

Blerësi, me kërkesën e Furnizuesit, do ti japë Furnizuesit të gjithë ndihmën në dispozicion në kryerjen e procedurave të tilla dhe do të rimburohet nga Furnizuesi për të gjitha shpenzimet e arsyeshme të kryera në këtë mënyrë.

Blerësi dëmshpërblen dhe zhdëmton Furnizuesin dhe punonjësit, dhe nënkontraktorët e tij nga dhe kundër çdo padie, veprimi apo procedure administrative, që Furnizuesi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që ekzistonte në datën e kontratës që lind nga ose në lidhje me çdo skicim, të dhëna, vizatim, specifikim apo dokument apo materiale të tjera të ofruara apo skicuara nga ose në emër të Blerësit.



## Neni 23

### Kufizimi i Përgjegjësisë

Me përjashtim të rasteve të neglizhencës së rëndë ose shkelje me dashje:

- (a) Furnizuesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj Blerësit, për ndonjë humbje apo dëm indirekt ose që ka si pasojë, humbje të përdorimit, humbje të prodhimit, ose humbje të fitimeve ose kostove të interesit, me kusht që ky përjashtim të mos zbatohet për asnjë detyrim të Furnizuesit për t'i paguar Blerësit dëmet e likujduara; dhe
- (b) përgjegjësia e përgjithshme e Furnizuesit ndaj Blerësit, nuk duhet të kalojë Çmimin e Kontratës, me përjashtim të rasteve për koston e dëmeve të rezultuara nga gabimet ose mangësitë në kryerjen e shërbimeve, ose çdo detyrim të Furnizuesit për të zhdëmtuar Blerësin në lidhje me shkeljen e patentës.

## Neni 24

### Ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjorë

Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Furnizuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

## Neni 25

### Forca madhore

- 25.1** Mos kryerja apo kryerja me vonesë nga ana e një Pale të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate nuk do të konsiderohet shkelje e kësaj Kontrate nëse një mospërmbushje apo vonesë e tillë vjen drejtpërdrejt për shkak të ndonjë ngjarje të Forcës Madhore.
- 25.2** Për qëllime të këtij neni, "Ngjarja e Forcës Madhore" do të thotë një ngjarje ose situatë përtej kontrollit të një Pale që nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme dhe nuk shkaktohet nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit nga njëra Palë. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, veprime të një Pale qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, luftërat ose revolucionet, zjarret, përmytjet, epidemitë/pandemitë, kufizimet e karantinës dhe embargo e mallrave.
- 25.3** Nëse ndodh një Ngjarje e Forcës Madhore, Pala e prekur do të njoftojë menjëherë Palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkakun e saj. Në qoftë se nuk udhëzohet ndryshe nga Pala tjetër me shkrim, Pala e prekur do të vazhdojë të kryejë detyrimet e saj sipas Kontratës për aq sa është e arsyeshme e praktikueshme dhe do të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për realizimin që nuk pengohen nga Ngjarja e Forcës Madhore

## Neni 26

### Modifikimi i Kontratës

- 26.1 Palët mund të modifikojnë kontratën gjatë afatit të saj, vetëm nëse ndodhen në ndonjë nga rastet e parashikuara në LPP.
- 26.2 Kur modifikimi shoqërohet me rritje të vlerës së Kontratës, vlera totale e modifikimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për përlogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar.
- 26.3 Asnjë modifikim i Kontratës nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të Blerësit, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Furnizuesit dhe Blerësit.

## Neni 27

### Zgjatja e afatit

- 27.1 Nëse në çdo kohë gjatë ekzekutimit të Kontratës, Furnizuesi ose nënkontraktorët e tij hasin kushte që pengojnë kryerjen në kohë të Shërbimeve në përputhje me Nenin 5, Furnizuesi njofton menjëherë Blerësin me shkrim për vonesën, kohëzgjatjen e mundshme dhe shkakun e saj. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së njoftimit të Furnizuesit, Blerësi vlerëson situatën dhe në bazë të diskrecionit të tij mund të zgjasë kohën e realizimit nga ana e Furnizuesit. Në këtë rast zgjatja miratohet nga Palët dhe reflektohet në modifikimin e Kontratës.
- 27.2 Me përjashtim të rastit të Forcës Madhore, siç parashikohet në Nenin 20, një vonesë nga Furnizuesi në kryerjen e detyrimeve të Dorëzimit dhe Përfundimit do ta bëjë Furnizuesin përgjegjës për pagesën e dëmeve të likujduara në përputhje me parashikimet në kontratë.

## Neni 28

### Ndërprerja e Kontratës

- 28.1 **Njoftim për të korrigjuar**  
Nëse Furnizuesi nuk përmbush ndonjë detyrim sipas Kontratës, Blerësi mund ti kërkojë me Njoftim që Furnizuesi të ndreqë mospërmbushjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.
- 28.2 **Ndërprerja për mospërmbushje**  
Blerësi, pa cenuar ndonjë mjet tjetër ligjor në lidhje me shkeljen e Kontratës, mundet me anë të një Njoftimi me shkrim për mospërmbushje që i dërgohet Furnizuesit, ta përfundojë Kontratën në tërësi ose pjesërisht:
- (i) nëse Furnizuesi nuk ka përmbushur detyrimin edhe pas Njoftimit të bërë sipas pikës 23.1 të këtij neni;

(ii) Nëse Furnizuesi nuk ka arritur të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në Kontratë, ose brenda ndonjë zgjatjeje të dhënë nga Blerësi në përputhje me Nenin 22; ose

(iii) Nëse provohet se Furnizuesi është angazhuar në Praktika të Ndaluara, siç përcaktohet në Nenin 2. gjatë konkurrimit për Kontratën apo ekzekutimit të saj.

### **28.3 Ndërprerja për paaftësi paguese**

Blerësi ndërpret në çdo kohë Kontratën duke njoftuar Furnizuesin nëse Furnizuesi falimenton. Furnizuesi ndërpret në çdo kohë Kontratën nëse Blerësi nuk ka aftësi paguese. Në një rast të tillë, ndërprerja do të bëhet pa kompensim për Furnizuesin, me kusht që kjo ndërprerje nuk do të cenojë ose ndikojë në ndonjë të drejtë padie apo mjeti ligjor që ka lindur apo do të lindë më pas për Blerësin.

### **28.4 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

a) Blerësi mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

b) Blerësi duhet të njoftojë me shkrim Furnizuesin për ndërprerjen.

c) Blerësi duhet të paguajë Furnizuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Furnizuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjeshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Furnizuesit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

## **Neni 29**

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

**29.1** Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore përmes bisedimeve të drejtpërdrejta çdo mosmarrëveshje që lind midis tyre gjatë ekzekutimit të Kontratës.

**29.2** Nëse, palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre me një konsultim të tillë të ndërsjellë, atëherë secila Palë mund t'i njoftojë Palës tjetër për qëllimin e saj për të shkuar në Gjykatë.

## **Neni 30**

### **Mbikqyrja e shërbimit**

**30.1** Bashkia Shkodër realizon mbikqyrjen e mirmbajtjes të gjelbërimit në territorin e Bashkisë Shkodër përmes procesit të monitorimit të shërbimit të mirmbajtjes të sipërfaqeve të gjelbërta me anë të inspektorëve të lagjeve të qytetit dhe njësisve administrative ku ofrohet shërbimi, dhe specialisti pranë drejtorisë të shërbimeve publike dhe ndjekjes të investimeve të infrastrukturës. Grupi i monitorimit në bashki ka përgjegjësi për monitorimin e realizimit të shërbimeve sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti Kontraktor. Monitorimi dhe mbikqyrja do realizohet sipas detyrave përcaktuar si më poshtë:

a) Specialistët/inspektorët monitorojnë dhe raportojnë në njësinë e monitorimit të shërbimeve publike/ drejtoria e shërbimeve publike dhe ndjekjes të investimeve të

infrastrukturës për zbatimin e shërbimeve sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti Kontraktor

- b) Njësia e monitorimit të shërbimeve publike/drejtoria e shërbimeve publike dhe ndjekjes të investimeve të infrastrukturës mbledh informacionin sipas monitorimit në terren I përpunon ato dhe informon Kontraktorin për shërbimin e munguar sipas grafikëve të shërbimit miratuar nga AK;
- c) Propozon AK për miratim detyra shtesë për ndërhyrje në sipërfaqe të gjelbëra publike apo insitucione nën administrimin e Bashkisë Shkodër
- d) Mbikqyrësi i njësië (specialisti) ndjek zbatimin e kontratës, verifikon volumet e punës dhe i paraqet pranë njësisë të monitorimit/drejtorisë të shërbimeve publike dhe ndjekjes të investimeve të infrastrukturës, si edhe bën propozimin për ndalesa dhe penalitete;
- e) Për problematikat e shfaqura kontakton me operatorin për marrjen e masave të menjëherëshme për për kruerjen e shërbimit të munguar sipas grafikut;
- f) Në fund te cdo muaji harton proces-verbalin për mbylljen e situacionit të punimeve , duke raportuar punët e kryera apo penalitetet e proceseve të punës të perealizuara
- g) Harton grafikët vjetor të cilët kanë të shprehur frekuencën e proceseve të punës që kryhen mbrenda muajit , mbi bazen e të cilit do të përcatohet vlera e saktë e situacionit mujor . Në rast ndryshimesh gjatë zbatimit të kontratës harton grafikët mujor dhe i paraqet për miratim AK, duke njoftuar me shkrim më pas operatorin sipërmarrës.
- h) Inspektorët e rajoneve/ përfaqësuesit e njësive, verifikojnë mbi bazën e grafikëve të punimeve mujore realizimin e proceseve të punës të miratuar nga Ak;
- i) Raportojnë cdo javë tek Drejtoria e shërbimeve publik dhe ndjekjes të investimeve të infrastrukturës, informacion me shkrim siaps formës të miratuar nga AK, për ecurinë e realizmit të grafikut të punimeve.

### Neni 31

#### Përfaqësimi i Palëve

**31.1** Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukture organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

- a) Struktura përgjegjëse, në emër të **Autoritetit Kontraktor** për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës do të jetë

**Drejtoria e Sherbimeve Publike dhe Ndjekjes se Investimeve të Infrastrukturës**

cel/tel/fax \_\_\_\_\_

E-mail: [sherbimetpublike@bashkiashkoder.gov.al](mailto:sherbimetpublike@bashkiashkoder.gov.al)

- b) Personi që do të jetë përgjegjës në emër të **Kontraktuesit** për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës do te jete **Ing.Skender Halilaj**.

cel/tel/fax: 0692502300

E-mail: [malvin.halilaj1@gmail.com](mailto:malvin.halilaj1@gmail.com)

MALVIN HALILAJ  
IMPEX  
SHKODER - ALBANIA



- 31.2** Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 31.3** Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit
- 31.4** Administratori i Kontrates ve ne dijeni Titullarin e Autoritetit Kontraktor per cdo rast e çeshtje dhe nuk mund t'i drejtohet Kontraktuesit pa marre me pare miratimin e Titullarit te Autoritetit Kontraktor.
- 31.5** Në zbatim të VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". kreu XIII, neni 107, pika 6, "Zbatimi dhe mbikqyerja e kontratës", në përfundim të kontratës, **Drejtoria e Sherbimeve Publike dhe Ndjekjes se Investimeve të Infrastrukturës** si struktura që do të jetë përgjegjës, në emër të Autoritetit Kontraktor për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës do të përgatisin një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit të kontratës dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti paraqet një informacion për likudimin ose jo të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.
- 31.6** Personi përgjegjës duhet të ndjekë me përpikëri ecurinë e zbatimit të kontratës, për t'u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës. Personi përgjegjës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka/në këto përgjegjësi:
- harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës;
  - kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë;
  - administron dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
  - sigurohet për kontrollin real e ligjor të kostove, cilësisë dhe afateve, kur është rasti;
  - menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk sjellin domosdoshmërisht ndryshime/ modifikime/ përshtatje të saj;
  - raporton te titullari i autoritetit/entit kontraktor për shkelje të dispozitave kontraktuale;
  - administron kërkesat për ndryshime/ modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë;
  - mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës;
  - përgatit informacion për çështjet e sipërcituara dhe ia përcjell personit përgjegjës për prokurimin, i cili raporton pranë APP-së

## Neni 32

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr 1, Shkodër, ëeb ëëë [bashkiashkoder.gov.al](http://bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)





## Penalite te për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale

Kontraktuesi do t'i nënshtrohet ndalesave nga Autoriteti Kontraktor. Bashkia Shkodër, si më poshtë vijon:


1. **Për mospërmbushje të detyrimit për "Mirembajtjen e Siperfaqeve te Gjelberta"** për lulishtet e Tipit A,B dhe C ;
  - ✓ Për cdo process pune të pa realizuar sipas grafikut " operatori penalizohet" përvec ndalesës për punë të pa kryer me dyfishin e cmimit përkatës për njësi i procesit;
2. **Për mospërmbushje të detyrimit për " mirembajtjen e gjelberimit rrugor",** të tipit 1,2,3 ;
  - ✓ Për cdo process pune të pa realizuar sipas grafikut " operatori penalizohet" përvec ndalesës për punë të pa kryer me dyfishin e cmimit përkatës për njësi i procesit;
3. **Për mospërmbushje të detyrimit për "Mirëmbajtja e sipërfaqeve ujore**
  - ✓ Për cdo process pune të pa realizuar sipas grafikut " operatori penalizohet" përvec ndalesës për punë të pa kryer me dyfishin e cmimit përkatës I procesit;
1. **Për mospërmbushje të detyrimit për "Mirëmbajtja e bimësisë në vazo dekorative**
  - ✓ Për cdo process pune të pa realizuar sipas grafikut " operatori penalizohet" përvec ndalesës për punë të pa kryer me me dyfishin e cmimit përkatës I procesit;
2. **Për mospërmbushje të detyrimit për "Mirëmbajtja e shkurreve dekorative**
  - ✓ Për cdo process pune të pa realizuar sipas grafikut " operatori penalizohet" përvec ndalesës për punë të pa kryer me dyfishin e cmimit përkatës I procesit;
3. **Për mospërmbushje të detyrimit për "Mirembajtja e stolave dekorativ**
  - ✓ Për cdo process pune të pa realizuar sipas grafikut " operatori penalizohet" përvec ndalesës për punë të pa kryer me dyfishin e cmimit përkatës I procesit;
4. **Për mospërmbushje të detyrimit për "Fidana lule sezonale**
  - ✓ Për cdo process pune të pa realizuar sipas grafikut " operatori penalizohet" përvec ndalesës për punë të pa kryer me dyfishin e cmimit përkatës I procesit;
5. **Për mospërmbushje të detyrimit për "Mbjellje drurë dekorativ (në lulishte dhe gjelbrim rrugor)**
  - ✓ Për cdo process pune të pa realizuar sipas grafikut " operatori penalizohet" përvec ndalesës për punë të pa kryer me dyfishin e cmimit përkatës I procesit;
6. **Për mospërmbushje të detyrimit për "Mbjellja shkurre dekorative**
  - ✓ Për cdo process pune të pa realizuar sipas grafikut " operatori penalizohet" përvec ndalesës për punë të pa kryer me dyfishin e cmimit përkatës I procesit;
7. **Për mospërmbushje të detyrimit për "Mbjellje bordurë e gjelbër**
  - ✓ Për cdo process pune të pa realizuar sipas grafikut " operatori penalizohet" përvec ndalesës për punë të pa kryer me dyfishin e cmimit përkatës I procesit;

8. Për mospërmbushje të detyrimit për "Sherbim i mirembajtjes se rruges se Kalase.
- ✓ Për cdo process pune të pa realizuar sipas grafikut " operatori penalizohet" përvec ndalesës për punë të pa kryer me dyfishin e cmimit përkatës I procesit;
9. Për mospërmbushje të detyrimit për "Sherbim i mirembajtjes se rruges se Shirokes dhe bregut te liqenit.
- ✓ Për cdo process pune të pa realizuar sipas grafikut " operatori penalizohet" përvec ndalesës për punë të pa kryer me dyfishin e cmimit përkatës I procesit;
  - ✓
10. Për mospërmbushje të detyrimit për "Pastrimi i bregut te liqenit( pjesa ujore)
- Për cdo process pune të pa realizuar sipas grafikut " operatori penalizohet" përvec ndalesës për punë të pa kryer me dyfishin e cmimit përkatës I procesit;
11. Për mospërmbushje të detyrimit për "Zëvendësim dhe shtim stola dekorativ
- Për cdo process pune të pa realizuar sipas grafikut " operatori penalizohet" përvec ndalesës për punë të pa kryer me dyfishin e cmimit përkatës I procesit;
12. Për mospërmbushje të detyrimit për "Zëvendësim dhe shtim kosha te vegjël per mbetje
- Për cdo process pune të pa realizuar sipas grafikut " operatori penalizohet" përvec ndalesës për punë të pa kryer me dyfishin e cmimit përkatës I procesit
- 32.13 Në respektim të proceseve përcaktuar nga Grafikët mujor/vjetor të miratuar nga AK, për mos realizimin në kohë ose sipas grafikut, operatori do të paralajmërohet me shkrim (email, shkresë, etj) për vendosjen e penaltetit për punën e pakryer. Në fund të muajit raporti/process-verbali/vendimi përkatës i penaltetit për punë të pakryer.
- 32.14 Në kushtet atmosferike të papërshtatshme për realizimin e proceseve të ndryshme të punës miratuar me Grafikun përkatës mujor/vjetor, mbikqyrësi përgatit njoftimin me shkrim për operatorin për pamundësinë e realizimit të procesit të planifikuar në grafik shoqëruar me propozimin e tij për grafikun e ri të punimeve. Bashkia Shkodër, Autoriteti Kontraktor pasi vlerëson propozimin, dhe e miraton atë me shkrim, njofton operatorin për zbatimin e grafikut të ri dhe nuk e penalizon operatorin.

### Neni 33

#### Lajmërimet

- 33.1 Menyra e komunikimit midis Autoritetit Kontraktor Bashkisë Shkodër dhe Kontraktuesit do të jetë me shkrim ose në mënyrë elektronike. Te gjitha njoftimet të cilat palet do të drejtojnë njëri tjetrit duhet të hartohen me shkrim dhe të dorëzohen personalisht, me postë zyrtare ose postë elektronike duke iu adresuar paleve në mënyrë me postë:
- a. Për përfaqësuesin e Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Shkodër adresa e plote e Institucionit ose adresa e postës elektronike [sherbimetpublike@bashkiashkoder.gov.al](mailto:sherbimetpublike@bashkiashkoder.gov.al)
  - b. Për përfaqësuesin e kontraktuesit, adresa e plote e kontraktuesit ose adresa e postës elektronike të cilat palet në cdo kohë ia komunikojnë njëri tjetrit me shkrim



[malvin.halilaj@gmail.com](mailto:malvin.halilaj@gmail.com)

33.2 Njoftimet do të kenë efekte me marrjen në dorezim nga palet.

### Neni 32

#### Llogaritja e Afateve

Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

### Neni 33

#### Vlefshmeria e kontratës

33.1 Kjo kontratë u hartua në gjashtë kopje origjinale. pesë për Autoritetin Kontraktor dhe një për Kontraktuesin, dhe pasi u lexua, firmoset rregullisht nga palet

33.2 Kjo kontratë do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

### Neni 34

#### Specifikimet teknike

#### SPECIFIKIMET TEKNIKE

**Objekti: Ofrimi i Shërbimit të Gjelbrimit në Bashkinë e Shkodrës**

✓ **Identifikimi dhe përshkrimi i shërbimit.**

Volumi i punimeve të mirëmbajtjes të gjelbërimit është i identifikuar dhe përshkruar në grupe të vecanta, në të cilat janë caktuar me zëra të hollësishëm të gjitha volumet përkatëse për çdo zë shërbimi mirëmbajtje, duke respektuar manualet teknike dhe eksperiencën e punës së deritanishme. Grupi kryesor i shërbimeve është:

### 13. Mirëmbajtja e Sipërfaqeve të Gjelbra

#### Klasifikimi tipologjik i shërbimit:

Sipërfaqet e gjelbërta ose lulishtet janë klasifikuar sipas intensitetit të gjelbërimit në tre kategori Tipi A, B dhe C përcaktuar si më poshtë:


- **Tipi A** (intensive) me **48742 m<sup>2</sup>**, (përfshihen kopshtet dhe parqet urbane me sipërfaqe më të madhe se 5000 m<sup>2</sup>, të kushtëzuar nga fluksi dhe frekuentimi i lartë e këtyre ambienteve rekreative. Këtu përfshihen sipërfaqet prej 31 251 në qytet dhe sipërfaqe 17 491 m<sup>2</sup> në plazhin e Velipojës.
- **Tipi B** (të rëndësishme) me sipërfaqe **39 051 m<sup>2</sup>** (klasifikohet si gjelbërim intensive me shërbime të ndryshme, zona të gjelbra të lagjeve, rreth rrotullime dhe parqe lojrash.
- **Tipi C** (mirëmbajtje të lartë) me sipërfaqe **23 838 m<sup>2</sup>** që kërkojnë mirëmbajtje të veçantë.

Meqënëse në qytetin e Shkodrës pothuajse të gjitha sipërfaqet e gjelbra janë të rikonstruara dhe të plotësuara me të gjitha elementet (si drure dekorativ, shkurre dekorative, gardhe të gjelbërta, bar natyral, lule, rruge e sheshe si dhe stola dekorativ) edhe në preventivin e hartuar për këtë shërbim janë trajtuar shërbimet e të gjithë elementeve.

Lulishtet e reja të përfituara nga ndërtimet dhe rikonstruksionet e blloqeve të banimeve si pjesë e investimeve të reja të Bashkisë Shkodër me një sipërfaqe prej **18 692 m<sup>2</sup>** janë përfshirë në

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr. 1, Shkodër, eeb eee [bashkiashkodër.gov.al](http://bashkiashkodër.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkodër.gov.al](mailto:info@bashkiashkodër.gov.al)

MALVIN SHPK  
K M P E X  
SHKODER ALBANIA



sipërfaqen e lulishteve për mirëmbajtje.

Përmbajtja e inventarit të përgjithshëm të zonave të gjelberta, në metër katror, tregohet në tabelën si më poshtë:

Tipet e sipërfaqeve të gjelbërta	Sasia (nr.)	Sasia (m <sup>2</sup> )
Tipi A: Qytet Velipoje	6	31.251 m <sup>2</sup> 17 491 m <sup>2</sup>
Tipi B	29	39 051 m <sup>2</sup>
Tipi C	31	23 838 m <sup>2</sup>

### Proceset e punës :

#### *1.a-Mirembajtja e barit të kultivuar:*

Punimet kryesore në mirëmbajtjen e barit janë:

- ✓ vadija e barit në periudhën e verës, e cila do të realizohet nëpërmjet vaditjes me tuba, me sprucator dhe në ato vende ku mungon uji, vadija do të realizohet me ujë shpimi duke kursyer kështu përdorimin e ujit të pijshëm nga rrjeti, me qëllimin kryesor që të mbulohen nevojat me ujë që ka bari i kultivuar. Vadija është llogaritur të bëhet në varësi të mungesës së reshjeve në periudhën Maj-Tetor.
- ✓ Kositja e sipërfaqeve të barit, do të realizohet 12 herë në vit (12 kositje). Kositja do të kryhet në fillim të muajit Prill deri në fund të muajit Tetor. Këtë proces do ta realizojmë me makina kositëse bari. Krahas saj në vende ku do të ketë dëmtime të sipërfaqes së barit do të bëhet riparimi i këtyre sipërfaqeve nëpërmjet mbjelljes me farë bari.
- ✓ Shpërndarje plehu organikë gjatë Tetor.

#### *1.b-Drurët dhe shkurret:*

Punimet kryesore në mirëmbajtjen e drurëve janë:

- ✓ krasitja e tyre, që realizohet në periudhën Dhjetor – Shkurt, periudhë në të cilën drurët janë në qetësi relative;
- ✓ Janë të parashikuara dhe proceset e punimit të tokës përreth drurëve dhe eliminimit të barërave të kqija përreth tyre;
- ✓ Për shkurret dekorative është parashikuar gjithashtu krasitja e tyre gjashtë herë në vit duke i dhënë forma të ndryshme dekorative;
- ✓ Për shkurret gjetherënëse krasitja bëhet gjatë dimrit dy herë në vit, ndërsa për ato gjethembajtëse krasitja bëhet edhe gjatë muajve të tjerë të vitit.

*1.c-Bordurat e gjelbra* janë parashikur të krasiten mesatarisht 1 herë në muaj (3 faqet) me qëllim mbajtjen e tyre në format e duhura dekorative. Po kështu edhe punimet e tokës përreth këtyre gardheve. Krasitja shkurreve do të kryhet: nje here ne muajin prill, 2 here ne muajt maj dhe qershor, nje here ne muajin korrik, nje here ne muajt gusht - shtator- tetor-nentor.

*1.d-Lulet sezonale në lulishte* janë një element i rëndësishëm. Gjatë vitit është parashikuar që



parteret në lulishte të jenë me lule gjatë gjith vitit. Theksojmë se përkëtë proces pune parashikohet mbjellja e fidanit të lules në lulishte dhe shërbimet në lule deri në marrjen e farës në lulishte. Llojet e luleve që do të përdorim janë: Viola pedunculata, Ciklamin, Taget, Salvia, Lulebora, Trëndafila etj. Mbjellja do te filloje ne muajin shkurt dhe me pas sipas stines se lules.

#### ***1.e- Mirmbajtje dhe fshirje rrugë dhe sheshe brënda në lulishte.***

Pastrimi i të gjithë sipërfaqes të gjelbërt referuar cdo lloji mirmbajtjeje që përmban mbledhjen dhe largimin e cdo lloji mbeturine të ngurtë (letër, xham, plastike, të bimësisë rastësore dhe gjetheve etj ). aktiviteti përmban edhe fshirjen, mbledhjen dhe heqjen e mbeturinave te cdo lloji te siperfaqeve te shtruara dhe/ose pedonale e brendshme e zones se gjelbert ose sheshit brënda lulishtes. Hapësira e pastrimit dhe fshirjes kuptohet deri ne limitin e karregjiates rrugore, prandaj trotuari qe ndan sheshin me zonen kuptohet si pjese perberese e sheshit ose zones për tu pastruar brënda lulishtes.

#### ***1.f Pastrim i lulishtes***

Pastrimi i lulishtes konsiderohet si një shërbim që nuk duhet ti mungojë lulishteve cdo ditë .pastrimi konsiston mbledhje mbetesh te hedhura nga qytetarë. Lulishtja duhet të jetë në kushte optimale për frekuentim të përditshëm nga banorët.

***1.g. Nitrifikim bari+lule :*** Ky proces pune realizohet zakonisht pas kositjes se siperfaqes se barit kryesisht gjatë muajve prill, maj, qershor,korrik, sipas karakteristikave dhe domosdoshmërisë që shfaq lulishtja. Nitratohet e gjithë sipërfaqja por dhe verifikohet aty ku bari ka njolla të verdha apo jeshile te zverdhur dhe nitrifikimi ka si qëllim qe te fuqizojë zhvillimin e barit me qëllim që bari të kthehet ne ngjyrën e gjelbër normale. Nitrifikimi shoqërohet menjehere me vaditjen me qëllim asimilimin sa më të shpejtë nga bari te elementit ushqyes azot. Tek lulet nitrifikimi realizohet duke shperndare nitratin ne parteret e luleve dhe menjehere pas saj bejmë prashitjen e sipërfaqes se luleve me qëllim permbysjen e nitratit ne toke dhe pastaj vaditjen e siperfaqes.

***1.h Shperndarje plehu organik:*** Kryesisht realizohet gjate muajve Janar-shkurt dhe ka si qellim pasurimin e tokes me lende ushqyese.Kryesisht shperndahet gjate punimit te tokes perreth pemeve,shkurreve,bordurave te gjelbra dhe luleve shumevjecare(trendafila, oleander,spirea,hibiscus etj.),gjithnje aty ku shikohet e nevojshme per nje zhvillim te mire te bimesise dekorative.

***1.j Mirembajtja e veprave arkitekturore :*** realizohet gjate pranveres dhe vjeshtes.Ky process ka qellim pastrimin e veprave arkitekturore nga oksidet e ndryshme qe krijohen ne keto vepra si rezultat i shirave te vazhdueshme gjate dimrit duke siguruar pastrimin e siperfaqes dhe pa demtuar keto vepra.

***1.k Luftimi i semundjeve(sperkatje) :*** Eshte nje process qe realizohet gjate muajve maj – qershor dhe ka per qellim luftimin e semundjeve dhe demtuesve ne lulet shume vjecare,shkurret,bordurat e gjelbra.Perdoret dhe per luftimin e insekteve te ndryshme per te ruajtur bimesine decorative.Sprkatja realizohet dhe ne raste te tjera per luftimin e barerave te keqia ne siperfaqet e barit aty ku ka zhvillim te madh te barerave qe duhen hequr.

***1.l Heqja e barerave te keqia rrugore :*** Eshte nje process qeka per qellim heqjen e barerave



ne rruge e sheshe Brenda lulishtes,kryesisht barera te keqia qe dalin ne rruge te brendshme ndermjet pllakave qe jane shtruar ne keto rruge te brendshme.Realizohet nepermjet prerjes me mjetin ferline, shkuljes me dore ose cap.

**1.m Heqja e barerave tek lulet me cap(mihje) :** Ky proces realizohet ne parteret e luleve per barera qe kane zhvilluar rrenje dhe duhen eliminuar duke perdorur capin..Heqja e barerave me cap behet edhe tek lulet shumevjecare( trendafile,oleander,hibiscus,spirea etj.)

#### 14. Mirëmbajtja e gjelbrimit rrugor

##### **Klasifikimi tipologjik i shërbimit :**

Procesi përfshin të gjitha ndërhyrjet prerëse apo krasitjeje që duhen kryer për një dru ose pemë të shëndetshme por edhe për nevoja të aksesueshmërisë,trafikut dhe sigurie (vizibilitet për kalimtarët, tabelat sinjalizuese etj). Drurët e gjelbrimit rrugor të qytetit të Shkodrës dhe Njësi Administrative me një numër total të preventivuar prej 6790 rrënjësh janë klasifikuar sipas lartësisë në tre Tipe:

- Tipi 1 (lartësi deri në 5 m) me 2986 copë
- Tipi 2 (lartësi 5 deri në 10 m) me 1824 copë
- Tipi 3 (lartësi 10 deri në 15 m) me 1980 copë

##### **Shërbimet kryesore në këto drurë dekorativ do të jenë:**

- ✓ Për drurët element i rëndësishëm është krasitja e tyre, që realizohet në periudhën **Dhjetor – Shkurt**, periudhë në të cilën drurët janë në qetësi relative, krasitjet e përvitshme dhe punimet e tokës përreth drurëve me qëllim eliminimin e barërave.Puna përfshin krasitjen rivitalizuese që duhet të kryhet për ekzemplarët e cdo lloji tipi sipas madhësisë dhe llojit. Ndërhyrja parashikon kontrollin konstant të pemtarisë përmes heqjes të degëve të thara e të prishura apo të rrezikshme, të degëve të dobëta dhe të holla që formohen zakonisht në qendër të kurorës. Është planifikuar hapja e gropës transporti i dheut vegjetal dhe plehut qëdo përdoret për mbjellje, druri dekorativ dhe vendosja e drurit mbajtës dhe koshave mbrojtës.
- ✓ Element i rëndësishëm është vadija e drurëve gjatë periudhës të thatësisë.

#### 15. Mirëmbajtja e sipërfaqeve ujore

Në mirëmbajtjen e sipërfaqeve ujore (shatërvane) është llogaritur të kryhet pastrimi nga papastërtitë që krijohen në to, çdo muaj, pra 12 herë në vit, kjo për qytetin, ndërsa sipërfaqja ujore në plazhin e Velipojës do të pastrohet 4 herë, vetëm gjatë sezonit turistik.

Proçeset që do të kryhen do jenë që nga heqja e ujit të ndotur nga shatërvani, larja e sipërfaqeve të pllakave me fshesa duke përdorur detergjentë, dezinfektimi, largimi i mbeturinave nga sipërfaqet ujore si dhe vënia në punë e shatërvanit nga personi i specializuar.

Janë llogaritur edhe punimet që do të kryhen në mirëmbajtjen e elektromotoreve si dhe pompave (riparimin e tyre) për të qënë në gatishmëri të plotë.

#### 16. Mirëmbajtja e bimësisë në vazo dekorative

Në këtë zë janë parashikuar shërbimet e krasitjes së shkurreve në vazo me qëllim mbajtjen e tyre në forma të përshtatshme dekorative, punimet e dheut në vazo për heqjen e barërave të

keqija. Me rëndësi do të jetë dhe vaditja e këtyre shkurreve në vazo gjatë periudhës së verës me bot uji.

#### **17. Mirëmbajtja e shkurreve dekorative**

Do të shërbehet në krasitjen e shkurreve duke i dhënë formën e duhur dekorative, punimet e tokës përreth tyre për eliminimin e barërave të keqija. Me rëndësi do të jetë dhe vaditja gjatë periudhës së verës dhe aty ku nuk ka mundësi vaditje me tub uji do të përdorim botin e ujit për vaditje.

#### **18. Mirembajtja e stolave dekorativ**

Në pjesën më të madhe të sipërfaqeve të gjelbra (lulishte) krahas elementeve të tjere janë vendosur edhe stola dekorativ për çlodhjen e qytetarëve do të bëhet mirëmbajtja e tyre. Këto stola janë të ndërtuar me konstruksion metalik dhe me ndenjese e mbeshtetese druri, si dhe me konstruksion betoni dhe ndenjese druri. Është llogaritur që çdo vit të bëhet riparimi i tyre. Riparimet konsistojnë në elementet metalike dhe ato të drurit mbasi ka dëmtime të tyre dhe në kushtet atmosferike të keqija struktura e dërrasës ka nevojë për riparime dhe lyerje me bojë vaji. Do të mirëmbahen gjatë gjithë vitit 464 copë stola dekorativ.

#### **19. F.V. Fidana lule sezonale**

Për këtë zë janë parashikuar mbjellje të fidanëve të luleve për tre sezone me tipologji lulesh tradicionale të qytetit, sipas kërkeses nga drejtorja e shërbimeve. Me këto fidanë parashikojmë të mbulojmë të gjitha nevojat me lule në lulishte gjatë gjithë vitit. Pra nje sipërfaqe e organizuar për mbjellje lulesh prej 535 m<sup>2</sup>, planifikohet të mbillet dy here në vit me një sipërfaqe të përgjithshme vjetore 1070 m<sup>2</sup>.

#### **20. Mbjellje drurë dekorativ (në lulishte dhe gjelbrim rrugor)**

Janë parashikuar të mbillen 200 copë në vit në lulishte dhe gjelbrim rrugor, si edhe zëvendësimi i drurëve që dëmtohen. Shërbimet që do të realizohen janë hapja e gropës, transporti i dheut vegjetal dhe plehut që do të përdoret për mbjellje. dru dekorativ dhe vendosja e drurit mbajtës dhe ekoshave mbrojtës.

#### **✓ Llojet e pemëve dhe të shkurreve**

Pemët që do mbillen do të jenë disa tipesh, të cilat do të përcaktohen në numra dhe lloje në bashkëpunim me specialistët e Bashkisë, duke i harmonizuar në plan-vendosje. Plani i mbjelleve dhe lloji i drurëve do të miratohen nga njësia e monitorimit në përshtatje me llojin e drurëve ekzistues në rrugë dhe lulishte. Drurët dotë jenë të tipeve. Likuidamos, Pisha, Ginko, Magnolia Santangeana.

Edhe shkurret do të vendosen në bashkëpunim me specialistët e Bashkisë dhe do jenë disallojesh. shkurret do të jenë. Kalistemum, Fotinja, Spirea, Oleander.

Lulet të jenë sipas përcaktimeve nga njësia e monitorimit të shërbimeve publike/ Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe ndjekjes të investimeve të infrastrukturës.

#### **21. Mbjellja shkurre dekorative**

Në këtë zë janë parashikuar të mbillen 120 copë shkurre dekorative në vit. Është planifikuar hapja e gropës, transporti i dheut vegjetal dhe plehut që do përdoret për mbjellje. Vendi dhe lloji do të përcaktohen sipas planit të miratuar nga njësia e monitorimit të shërbimeve publike

/Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes Të Investimeve Të Infrastrukturës në përshtatje me llojin e shkurrës në rrugën apo lulishten përkatëse.

## **22. Mbjellje bordurë e gjelbër**

Në këtë zë janë planifikuar të mbillet 150 ml bordure e gjelbër në vit. Është planifikuar hapja e kanalit dhe transporti i dheut vegjetal që do përdoret për mbjellje.

## **23. Shërbim i mirëmbajtjes së rrugës së Kalasë.**

Duke u vlerësuar si një objekt i një rëndësie të vecantë për historinë e qytetit të Shkodrës, atraksion turistik që tërheq vëmendjen e mijrave turistëve nga brenda dhe jashtë vendit, kërkohet një vëmendje e shtuar në mirëmbajtjen dhe shërbimin që i bëhet gjelbërimit të kësaj zone.

Parashikohet që të mirëmbahen 9440 m<sup>2</sup> gjithsej në vit ku do të realizohen pesë ndërhyrje përgjatë vitit sipas nevojave, problematikes që krijohet dhe sipas grafikut të dhënë nga njëësia e monitorimit të shërbimeve publike/ Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes të Investimeve të Infrastrukturës.

## **24. Shërbim i mirëmbajtjes së rrugës së Shirokës dhe bregut të liqenit.**

Ndërhyrja e cila do të realizohet në mirëmbajtjen e 4 km gjatësi lineare përmban këto procese: **a-Pastrimi i të gjithë rrugës pedonale të bicikletave gjatë bregut të liqenit**, duke e pastruar nga barerat që dalin në mes të pllakave dhe anash bordurave të trotuareve.

Është llogaritur që të bëhen gjashtë ndërhyrje gjatë gjithë vitit për këtë shërbim, sipas një grafiku të detajuar të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

**b-Pastrimi i bregut të liqenit dhe anash rrugës prej shkurreve të vogla dhe bimësive të larta.** Kjo sipas grafikut të drejtorisë së shërbimeve Publike për ndërhyrje dy herë në vit.

## **25. Pastrimi i bregut të liqenit (pjesa ujore)**

Duke marrë në konsideratë papastërtitë e mëdha që mbledhen në breg të liqenit, si dhe algat që krijohen prej ujit, mbetje druri e plastike, bëhet e domosdoshme pastrimi i bregut të ujit.

Është parashikuar që ky shërbim të kryhet në një gjatësi prej 1 km dhe në thellësi uji deri në 20 metra. Ky shërbim do të kryhet 2 herë në vit.

Shërbimi do të kryhet në koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, sipas një grafiku të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, për vendin e shërbimit dhe kohën e kryerjes së këtij shërbimi.

## **26. Zëvendësim dhe shtim stolave dekorativ**

Krahas mirëmbajtjes së stolave dekorativ është parashikuar të bëhet zëvendësimi i stolave të amortizuara ose të dëmtuara rëndë si dhe plotësimi i tyre në hapësirat e lulishteve ku mungojnë në qytet dhe Njësitë Administrative. Parashikohen mesatarisht vendosja e 70 copë stolave të rinj sipas planit të miratuar nga njëësia e monitorimit të shërbimeve publike /Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes të Investimeve të Infrastrukturës dhe llojit që do të përcaktohet në lulishten përkatëse.

## **27. Zëvendësim dhe shtim kosha të vegjël për mbetje**

Është parashikuar të bëhet zëvendësimi i koshave të vegjël për mbetje të amortizuara ose të dëmtuara rëndë si dhe plotësimi i tyre në hapësirat e lulishteve ku mungojnë në qytet dhe Njësitë Administrative. Parashikohen mesatarisht vendosja e 70 copë koshave të vegjël të kapacitetit

20-30 litra sipas planit të miratuar nga njësia e monitorimit të shërbimeve publike /Drejtoria e shërbimeve publike dhe ndjekjes të investimeve të infrastrukturës dhe llojit që do të përcaktohet në lulishten përkatëse.

## 1. Drurë dekorativ

### Kushte teknike të përgjithshme

- Trupi i tyre duhet të jetë i drejtë dhe i padëmtuar.
- Kurora e fidanit duhet të jetë e zhvilluar mirë dhe duhet të ketë më shumë se tre degëzime.
- Nuk duhet të ketë degëzim të tharë.
- Sistemi rrënjor duhet të jetë i zhvilluar dhe i shëndetshëm.
- Ambalazhimi i rrënjëve duhet të jetë me qese me diameter 30-40cm dhe lartësi 60 cm, ose në vazo transpiantuar qysh një vit më parë.
- Si trupi ashtu edhe degëzimet e fidanit duhet të jenë të painfektuara dhe të padëmtuara nga insektet.
- Gjethet duhet të kenë ngjyrën karakteristike të kultivarit.

### Kushtet teknike të veçanta

- Moshë e fidanit të drurit dekorativ duhet të jetë mbi 8 vjeç.
- Lartësia e fidanit pa sistem rrënjor duhet të jetë mbi 2.5 m.
- Diametri i qafës së rrënjës duhet të jetë jo më pak se 9 cm.
- Diametri i kërcellit në 1m lartësi 6-8 cm.
- Lartësia e sistemit rrënjor duhet të jetë mbi 40 cm.
- Diametri i kurorës së krasitur të jetë jo më pak se 50 cm.

## 2. Shkurret dekorative

### Kushte të përgjithshme

- Shkurret duhet të jenë me kërcell të rregullt me më shumë se 5 degëzime
- Me kurorë të krasitur ose me forma pa dëmtime të bisqeve
- Pa degëza të thara
- Me sistem rrënjor të zhvilluar mirë dhe i shëndetshëm
- Rrënjët dhe degëzimet të painfektuara dhe pa dëmtime nga insektet.
- Ambalazhimi i sistemit rrënjor duhet të jetë me qeska qysh kohë më parë.

### Kushtet teknike të veçanta

- Moshë 4-5 vjecare
- Lartësia e fidanit pa sistem rrënjor duhet të jetë mbi 50 cm
- Diametri i kurorës së krasitur të jetë mbi 40 cm.
- Diametri i kërcellit në rreth 2 cm.

### **Kushtet teknike te fidaneve te luleve**

- Fidanet e luleve duhet të jenë të zhvilluara në qeska të trajtuara me plehra dhe të kalitura në serë.
- Duhet të kenë një lartësi jo më pak se 15cm me kercëll të shëndoshë,
- Të jetë me kurora të zhvilluara me më shumë se 3 bisqe, të çelura ose të paktën të gonxhuara.
- Mbjellja e fidaneve nëpër lulishtedo realizohet sipas njëprojekti të dhënë nga Drejtoria e Shërbimeve, për të gjitha lulishtet ku do vendoset të mbillet.

## **KUSHTET E VEÇANTA TË KONTRATËS**

Kushtet e mëposhtme të veçanta të Kontratës do të plotësojnë KPK. Nëse ka një konflikt, dispozitat e KVK do të mbizotërojnë mbi ato në KPK.

### **Neni 1**

#### **Dispozitat e Përgjithshme**

- 1.1** Blerësi është: **Bashkia Shkodër**  
Adresa: Rr. "13 dhjetori", Nr. 1 Shkodër  
Telefoni: +35522400150  
Numri i faksit: \_\_\_\_\_  
E-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)
- 1.2** Furnizuesi është: "Malvin" sh.p.k.  
Adresa: **Rruga Jorgji Karamitri-Shkoder**  
Telefoni: 0684024401  
Numri i faksit: \_\_\_\_\_  
E-mail: [malvin.halilaj1@gmail.com](mailto:malvin.halilaj1@gmail.com)
- 1.3** Gjuha për komunikimet është: **Gjuha shqipe**  
Gjuha është: **Gjuha shqipe**

### **Neni 2**

#### **Sigurimi i Kontratës**

- 2.1** Sigurimi i Kontratës në shumën prej (10% të vlerës së ofertës) **Nuk Ka**

### **Neni 3**

#### **Vendndodhja e Shërbimeve**

- 3.1** Shërbimet do të kryhen në vendet sipas përcaktimeve në preventive dhe raportin teknik.

### **Neni 4**

#### **Fillimi i Zbatimit**

- 4.1** Zbatimi i kontratës duhet të filloje me **01.01.2023** deri me **31.12.2023**.

### **Neni 5**

#### **Informacion që duhet dhënë nga Autoriteti Kontraktor**

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr. 1, Shkodër, eeb eëë [bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al), E-mail [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)





- 5.1 Perpara nenshkrimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme:
- Grafikon e shërbimit deri në perfundim të kontrates,
  - Për çdo shërbim që kërkohet sipas nevojave të Autoriteti Kontraktor, kontraktuesi do të lajmërohet me shkrim për kohën dhe vendin e shërbimit.

#### Neni 6

##### Kërkesat e Raportimit

- 6.1 Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm: Në përputhje me grafikon e shërbimit.

#### Neni 7

##### Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

- 7.1 Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjësisë profesionale me shumë minimale si vijon: Nga Data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion që mbulon deri në shumën prej:
- a. Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve.
  - b. Për dëmtime ose humbje të Pajisjeve.
  - c. Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Punëve, Materialeve dhe Pajisjeve.
  - d. Për dëmtim personal ose vdekje të personave në kantier.

#### Neni 8

##### Kushtet e Pagesës

- 8.1 Pagesa per sherbimet , do te behet brenda 30 diteve nga dita e dorezimit te situacionit mujor te sherbimit
- 8.2 Autoriteti Kontraktor siguron kontraktuesin per pagesen ne afat te sherbimeve te kryera. Pagesa do te kryhet ne baze te situacionit mujor te paraqitur nga Kontraktuesi me vlere sipas volumeve te kryera, duke u zbritur masa e volumeve te sherbimit te pakryer si dhe penalitetet e mbajtura per pune te pakryer. Ne situacion duhet te perfshihet vlere e T.V.SH.
- 8.3 Koha e përcaktuar për të përmbushur detyrat deri në njoftimin e operatorit të shërbimit të gjelberimit dhe dorëzimi i dokumentacionit nga ana e këtij të fundit është data 03-05 të cdo muaji. Në rast mos rakordimi për situacionin e shërbimit mujor ose dokumentacionin mbështetës ku si rrjedhojë sjell vonesa në zbatim të këtij afati, komunikimi midis palëve realizohet me shkrim dhe afati nis ditën kur të dy palët bien dakord.
- 8.4 Supervizori/Administratori i Kontrates ben miratimin e pageses vetem ne rast se eshte plotesuar dokumentacioni i meposhtem:  
Faturen/at tatimore të shërbimit, lëshuar nga Kontraktuesi e cila dorezohet ne forme elektronike  
Situacionin te firmosur nga supervizori i sherbimit

Proces-verbalin e marrjes në dorëzim të shërbimit (1 Original)  
Monedha e pageses do te jete: LEKE.

- 8.5 Ne rast ndryshimi te llogarise nga ana e Kontraktuesit ky i fundit eshte i detyruar te njoftoje paraprakisht Autoritetin Kontraktues, Bashkine Shkoder.
- 8.6 Në zbatim të ligjit nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar, fatura e leshuar nga kontraktuesi duhet te jete elektronike.

### Neni 9

#### Pagesa Paraprake

- 9.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë (nuk ka) .Nëse nuk është specifikuar, Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.
- 9.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda (nuk ka) ditëve nga marrja e sigurimit te kontrates.
- 9.3 Në se jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet Kontraktuesit sipas formulës së mëposhtme: Nuk ka

### Neni 10

#### Shërbimet në Lidhje me to

Kushtet e veçanta të mëposhme do të zbatohen për kryerjen e pagesës së shërbimeve të lidhura.

### Neni 11

#### Zbritja e garancisë së kontratës

Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë. Nuk parashikohet zbritje e garancise se kontrates. Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

### PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR

#### BASHKIA SHKODËR

Kryetar i Bashkisë

Bardh SPAHIA



### PËR OPERATORIN EKONOMIK

“Malvin” Sh.p.k

Administrator ligjor

Skender HALILAJ

